

Mësuesi si ndërmjetës i mësimit të gjuhës

1. Mësimi i gjuhës përmes përdorimit. Roli i mësuesit.
2. Roli i tretë i mësuesit si ndërveprues

1. Mësimi i gjuhës përmes përdorimit. Roli i mësuesit.

Roli i mësuesit është mjaft i rëndësishëm në të gjithë procesin e mësimdhënies, por edhe më kyç është ky rol në mësimin e gjuhës. Sa i përket veprimeve dhe vendimeve të paramësimore (d.m.th. ato gjëra që mësuesit mund ose duhet të marrin para se të hyjnë në klasë për të mësuar një mësim ose kurs të veçantë), duhet theksuar se mësuesit mund të luajë një rol vendimtar në zgjedhjen e përmbajtjes dhe përcaktimin e fokusit të aktiviteve në klasë. Edhe pse shumica e mësuesve punojnë në një kontekst institucional të një vendi të caktuar, pra sipas disa udhëzimeve në lidhje me objektivat (zyrtare) të arritjes, objektivat e të mësuarit, procedurat e vlerësimit dhe madje punojnë me një libër mësimor ose plan-program të paracaktuar, ka shumë mësues rreth botës të cilët mbajnë një shkallë të caktuar të autonomisë. Ndër të tjera, ata marrin vendosin (të paktën pjesërisht) cilat detyra dhe ushtrime do të duhet t'i përgatisë nxënësi ekspozuar, cila pjesë e tekstit do të mbulohet nga mësuesi dhe cila nga nxënësit. Për më tepër, në shumicën e rasteve, janë mësuesit që kontrollojnë afatin kohor të aktivitetit në klasë. Megjithatë parimet didaktike lejojnë që secili mësues të ketë diku më shumë e diku më pak autonominë e vet.

Ata vendosin se sa kohë do të shpenzohen për çdo pikë të strukturës së orës së mësimit, sa kohë do të marrë një diskutim i veçantë në tërë klasën dhe sa kohë do t'i kushtohet kryerjes së një detyre të veçantë. Edhe mësuesit, të cilët punojnë me një program mësimor të bazuar në detyra, janë ata që e planifikojnë planin e punës së një ore mësimi e cila do të zhvillohet të nesërmen.

Mësimi i gjuhës e në këtë rast edhe i gjuhës shqipe, ka specifikat e saj. Përgjithësisht nga pikëpamja metodike mënyra më e mirë për të mësuar një gjuhë është **përdorimi i saj**, edhe për faktin se sot fëmijët janë të ekspozuar jo vetëm me një gjuhë, por shpesh me dy a tri të tilla. E kemi përmedur edhe më parë që si në pasurimin e fjalorit të nxënësve, ashtu edhe për vënien në praktikë të këtij mjeti komunikimi

është pëballja e nxënësve me situata të ndryshme gjuhësore. Kështu në një moment të caktuar mësuesi lë mënjanë plan-programin dhe vendos t'u mësojë fëmijëve gjuhën jashtë klasës duke përgatitur më parë një plan aktivitesh. Ai ka përpiluar më parë një itinerar, të cilin ia shpërndan fëmijëve të nesërmen. Mësuesi i orienton nxënësit që të mbajnë shënime gjatë vizitave që do të bëjnë.

Ai mund t'i dërgojë nxënësit p.sh. në *pazar*. Gjatë rrugës mësuesi i orienton për shenjat rrugore, duke bërë edhe një ndërthurje jo vetëm brendalëndore, por edhe ndërlëndore. Nxënësi përballlet jo vetëm me gjuhën standard, por edhe varietet të ndryshme gjuhësore. Një tjetër vend interesant mund të jetë *banka*, kështu mësuesi i dërgon nxënësit për të kryer sesi kryhen disa veprime bankare dhe se si përdoret gjuha në këtë rast. Ai gjithashtu mund t'i dërgojë në një zyrë turistike. Mësuesi ka bërë një bisedë paraprake me njerëzit që do të takojnë me qëllim që ta orientojnë bisedën drejt atyre elementeve që i ineteresojnë mësuesit. Kështu nëse i referohemi rastit të vizitave të mësipërme, duhet thënë se mësuesi i ka ndarë fëmijët në grupe në mënyrë që ato të mbështesin njëri-tjetrin. Gjatë vizitave mësuesi i nxit fëmijët të bëjnë pyetje të ndryshme në mënyrë që ata të marrin informacione shtesë.

Nxënësit janë të angazhuar me detyra të ndryshme gjatë vizitave, ata e përdorin gjuhën gjatë gjithë kohës dhe përballen me të gjatë të folurit, të shkruarit, të dëgjuarit. Ata ndërveprojnë me anë të gjuhës dhe mësuesi është:

- **partner** dhe ka rolin e **motivuesit** (duke i nxitur fëmijët në përgatijen dhe realizmin e projektit),
- **organizatorit** (duke organizuar vendin e vizitës, kohën etj.),
- **përkrahës i bisedave**
- **ndërveprues.**

Është e qartë se ka një numër të pafund mënyrash me të cilat mësuesit mund ta vënë këtë praktikë gjuhën e nxënësve, duke i përfshirë ato nëveprime të tilla, si: theksimi i qëllimeve të mësimi, duke theksuar dobinë në jetën reale të asaj që nxënësit do të mësojnë, duke ngritur një pyetje interesante ose duke ndjekur një temë që nxënësit kanë prezantuar. Nuk mjaftojnë vetëm aktivitet jashtë klasës për të arritur qëllimet e të mësuarit të gjuhës, po mësuesi ka në dispozicion edhe aktivitete të tjera. Ai duhet të organizojë aktivitete të ndryshme në klasë që nxënësit të jenë vazhdimisht të aktivizuar dhe të jenë të gatshëm për të përballuara edhe sfidat gjuhësore.

Duke pasur parasysh faktin se të mësuarit është një proces që mësuesit nuk mund realizojnë pa nxënësit dhe nga ana tjetër, nxënësit duhet që në mënyrë aktive të investojnë energji në procesin e tyre të të mësuarit. Mësuesit kanë një rol vendimtar në motivimin dhe aktivizimin e të gjithë nxënësve. Për t'u arritur ky qëllim duhet që mësuesi gjatë orës t'u japë nxënësve udhëzime të qarta, t'i vendosë ata në grupe, të organizojë diskutime, të marrë mendimin e shumicës për vlerësimin e nxënësve etj.

2. Roli i tretë i mësuesit si ndërveprues

Në literaturën bashkëkohore didaktike po flitet gjithnjë e më tepër për rolin e mësuesit si **ndërveprues**. Për realizimin e këtij misioni mësuesi duhet:

- ✓ të angazhohet në negocimin e të kuptuarit, ndërsa nxënësit duhet të përpiqen që të merren me kërkesat e *input*-it dhe të *output*-it të ngritura nga detyra.
- ✓ Mësuesi duhet të prodhojë një shumëllojshmëri pyetjesh, si shenjë nxitjeje për nxënësit duke përdorur teknika të ndryshme.
- ✓ Mësimdhënësi duhet të japë një *feedback* për përgjigjet e nxënësve. Reagimi mund të jetë në forma të ndryshme, duke përfshirë korrigjime të qarta, përsëritje, konfirm dhe kërkesa për sqarim, komentet metalinguistike, zgjerime dhe përpunime etj.

Si mund t'i realizojë mësuesi këto detyra sipas situatave të lartpërmendura?

Për t'i realizuar këto detyra mësuesi në fund të vizitës së parë p. sh. në një dyqan ai i pyet fëmijët për kuptimin e fjalëve të ndryshme, i ndihmon ato për të kuptuar ndonjë fjalë që nuk e kanë kuptuar. Mësuesi duhet të krijojë jo vetëm një mbështetje *njohëse* tek fëmijët, por edhe *motivuese* e *emocionale*. Ai duhet të jetë përkrahës i përhershëm i tyre. Për shembull, mësuesit duhet të përpiqen të krijojnë një klimë të sigurt në klasë e jashtë saj, në të cilën nxënësit ndihen tepër të qetë, ato flasin dhe praktikojnë aftësitë e tyre gjuhësore. Mësuesi duhet t'i trajtojnë të gjithë nxënësit me respekt, duhet t'i mbajnë fëmijët të motivuar, duke u dhënë atyre reagime pozitive, për të rritur vetëbesimin dhe t'i inkurajojë ata të vazhdojnë edhe nëse detyra është e vështirë.

Mësuesit e gjuhës dhe nxënësit ndjehen, sillen dhe bashkëveprojnë ndryshe nga dita në ditë, dhe gjuha dhe detyrat që ata punojnë ndryshojnë, duke e bërë çdo mësim unik.

Pas kryerjes së detyrave, mësuesit mund të përdorin fazën pas-detyrë për të parë performancën e nxënësve (p.sh. diskutojnë dialogjet në dyqanet me nxënësit), diskutojnë strategjitë që përdorën nxënësit, përmbledhin mësimet kryesore që nxënësit mund të nxjerrin përfundime, diskutojnë pyetje specifike. Në fazën pas-detyrë, gjithashtu, mësuesit pritët të vlerësojnë performancën e detyrave të nxënësve dhe zhvillimin e gjuhës.


Këtë mund ta bëjnë duke përdorur teste të standardizuara zyrtare të përfshira në plan-programet e tyre, por mësuesit mund të krijojnë edhe vetë teste (të bazuara në detyra) ose të përdorin vëzhgimin e tyre të përhershëm dhe vlerësimin e performancës së detyrave të nxënësve gjatë orëve të rregullta të klasës, si bazë për vlerësimin e tyre.

Nga perspektiva e bazuar në detyra, mësuesit pritët të përdorin detyrat për qëllime vlerësimi.

Këto aktivitete e bëjnë mësuesin një ndërveprues të mirë në mësimin e gjuhës.


Orë model:

Ditari



https://www.youtube.com/watch?v=jwy_GM0g5Cc&ab_channel=EduinoE-UcilnicaEduinoE-Ucilnica

Poezia



https://www.youtube.com/watch?v=qG7IOEwnGhU&ab_channel=MinistriaeArsimit%2CSportitdheRinis%C3%AB